



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

VENDIM

NR. 36, datë 31 : 05 : 2024

“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” PËR Z. ROLAND KARALLI (pas vdekjes)”

Në kuadër të vlerësimit të figurës së Z. Roland Karalli, si dhe në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit", V.K.M Nr. 861, datë 10/12/2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimorë për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit", Këshilli i Bashkisë i mbledhur në datën _____. _____. 2024, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, për dhënie tituli "Qytetar Nderi" për Z. Roland Karalli, si dhe mbështetur në relacionin e Komisionit Vendor për Dhënien e Titujve të Nderit,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e titullit “Qytetar Nderi” për Z. Roland Karalli (pas vdekjes) me motivacionin:

“Për kontribut të shquar në mjekësi, për përkushtimin, profesionalizmin dhe humanizmin e treguar gjatë gjithë karrierës së tij në shërbim të qytetarëve të Qarkut Gjirokastrë, për vlerat si kirurg dhe qytetar i denjë”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ